



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 928/5 Prot.

Tiranë, më 01.04. 2016

**V E N D I M**  
**Nr. 40, datë 01.04.2016**

**Mbi përfundimin e procesit të verifikimit,  
filluar me Urdhrin nr. 928/1 prot., dt. 05.01.2016**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, neneve 80-104, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e verifikimit të kryer në Bashkinë Cërrik, për rastin e nëpunëses \*\*\*\*\*,

**VËREJ SE :**

Mbi bazën e informacionit të përcjellë nga punonjësja \*\*\*\*\*, rregjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 928 prot., datë 21.12.2015, Komisioneri ka nxjerrë urdhërin e verifikimit, nr. 928/1 prot, të datës 05.01.2016, për të kryer veprime të mëtejshme për të sqaruar problemin e ngritur në këtë rast, i cili ka të bëjë me parregullsi gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil.

Në zbatim të këtij akti, u krye hetimi i plotë administrativ, u administrua dokumentacioni i nevojshëm për trajtimin e plotë të rastit dhe më pas u vlerësua ligjshmëria e veprimeve administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, për shkak ristrukturimi, të punonjësës \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës "Përgjegjëse e Zyrës së Financës", në Njësinë Administrative Gostimë, Bashkia Cërrik.

Nga analiza e akteve të administruara rezulton se, punonjësja \*\*\*\*\* ka filluar punë, në datën 27.11.2013, me aktin e emërimit nr. 28, datë 27.11.2013, në pozicionin e punës "Inspektor i Tatim Taksave", në Komunën Gostimë.

Fillimi i efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, e ka gjetur këtë punonjëse në të njëjtin pozicion pune, e për këtë shkak, me të drejtë, me aktin nr. 561 prot., datë 03.11.2014, të njësisë përgjegjëse të Komunës Gostimë, ajo është deklaruar "Nëpunëse civile, në periudhë prove".

Më tej, rezultojnë e provuar se, me Urdhrin nr. 5, datë, 25.02.2015, të Kryetarit të Komunës, ajo është emëruar, *(pa respektuar procedurën ligjore, pasi tashmë kisin filluar efektet juridike të ligjit)* në pozicionin e punës *“Përgjegjëse e Zyrës së Financës”*, në Komunën Gostimë.

Ndërkohë, duke u bazuar në ligjin nr. 115/2014 *“Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”* dhe në ligjin nr. 30/2015 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”*, Këshilli Bashkiak Cërrik, me Vendimin nr. 3/1, datë 10.08.2015, ka miratuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të bashkisë, institucioneve në varësi dhe të njësisve administrative të cilat tashmë janë pjesë përbërëse të saj.

Mbi këtë bazë, Kryetari i Bashkisë Cërrik, me Urdhrin nr. 35, datë 01.09.2015, ka miratuar strukturën tranzitore të administratës së institucionit, ku bëjnë pjesë edhe njësitë administrative.

Sipas kësaj strukture, rezultojnë se Njësia Administrative Gostimë, ka pësuar shkurtim real të vendeve të punës, nga **80** pozicione, prej të cilave **14** të përfshira në shërbimin civil që kishte struktura e mëparshme, në **29** pozicione, në strukturën e re, prej të cilave vetëm **4** pozicione pune janë pjesë e shërbimit civil.

Nisur nga ky fakt, arrihet në përfundimin se, subjekti është përfshirë në procesin e ristrukturimit, pasi rezultojnë se ka pësuar shkurtim të numrit të përgjithshëm të pozicioneve të punës dhe riorganizim të tyre.

Nga analiza e dokumentacionit të administruar në këtë rast, konstatohet se nga ana e institucionit është respektuar procedura e përcaktuar në nenin 50, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil” (i ndryshuar)*. Mbështetur në pikën 6, të kësaj dispozite, nga ana e institucionit është njoftuar punonjësja \*\*\*\*\* për përfshirjen në procesin e ristrukturimit, fillimisht me shkresën nr. 358 prot, datë, 21.09.2015 *“Për zbatimin e procedurës së ristrukturimit”* dhe më pas, me shkresën nr. 615/4 prot, datë 21.10.2015, *“Për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, në njësinë administrative Gostimë, për shkak ristrukturimi”*, është urdhëruar ndërprerja e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, për këtë punonjëse.

Në rastin konkret, konstatohet se procedura e kryer për ndërprerjen e marrëdhënies të punës për ata punonjës pjesë e shërbimit civil, që u është shkurtuar, apo ristrukturuar pozicioni i punës, është në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe në Kreun II dhe III, të Vendimit nr. 171 dt. 26.3.2014 *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”*.

Sipas dokumentacionit të administruar, rezultojnë se në zbatim të pikës 3, të kësaj dispozite, është ngritur Komisioni i Ristrukturimit në Bashkinë Cërrik, i cili ka shqyrtuar gjithë mundësitë e sistemit, për secilin prej nëpunësve civilë, në vendet e lira të mbetura apo riorganizuar dhe më pas ka bërë propozimin përkatës për njësinë përgjegjëse, për transferimin e nëpunësve në një vend pune ku përmbushen kërkesat specifike. Kjo veprimtari është materializuar në aktet si, 1) Urdhri për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit; 2) materialet që dokumentojnë mënyrën se si ka funksionuar ky komision dhe propozimet e tij, në lidhje me transferimet, rrimërimet dhe lirimet nga shërbimi civil, të punonjësve të institucionit, të cilëve u është shkurtuar, apo

ristrukturuar pozicioni i punës; 3) aktet që dokumentojnë vendimmarrjen përfundimtare nga njësia përgjegjëse, për miratimin, apo mosmiratimin e propozimeve të Komisionit të Ristrukturimit, e akte të tjera në lidhje me këtë aspekt.

Duke krahasuar strukturën e mëparshme të institucionit, me strukturën e re të miratuar, konstatohet se, pozicioni i punës *“Përgjegjës i Zyrës së Financës”*, ku punonte efektivisht kjo punonjëse në momentin e ristrukturimit, si edhe pozicioni i mëparshëm, *“Inspektor i Tatim Taksave”*, ku ajo punonte në momentin e fillimit të efekteve të ligjit aktual për nëpunësin civil, janë shkurtuar.

Në këtë rast, detyra e Komisionit të Ristrukturimit, duke u bazuar në rregullin e përcaktuar në pikat 1 dhe 2, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; në Vendimin nr. 171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”* dhe Udhëzimin nr. 3, datë 14.04.2014, të DAP *“Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”*, ishte të vlerësonte ndërmjet të tjerave, nëse ekzistonte mundësia për sistemimin në ndonjë pozicion të mbetur, të ish punonjësës  
\*\*\*\*\*.

Në përfundim të këtij veprimi administrativ, nga ana e Komisionit të Ristrukturimit, nuk është gjetur asnjë mundësi për sistemimin e saj, prandaj është paraqitur propozimi përpara njësisë përgjegjëse, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, mbi bazën e të cilit njësia përgjegjëse, ka nxjerrë aktin nr. 6/5 prot., dt.21.10.2015, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të nëpunësës  
\*\*\*\*\* për shkak të ristrukturimit. Ky akt është nxjerrë duke respektuar rregullat dhe procedurën e parashikuar nga neni 50, i ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, kreu III *“Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”*, i Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”* dhe Udhëzimit nr. 3, datë 14.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike *“Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes, apo ristrukturimit”*.

Nga sa analizuam më sipër, vihet re se nga pikëpamja procedurale, njësia përgjegjëse ka vepruar drejt në këtë rast ristrukturimi, por nëse rasti i punonjësës \*\*\*\*\* analizohet në përmbajtje akti i ndërprerjes së marrëdhënies së punës me institucionin, konstatohen disa parregullsi, të cilat do të analizohen më poshtë.

Sipas akteve administrative që bejnë të mundur verifikimin e statusit të punësimit për punonjësën në fjalë, rezulton se ajo ka filluar punë në datën 27.11.2013, me aktin e emërimit nr. 28, datë 27.11.2013, në pozicionin *“Inspektor i Tatim Taksave”*, në Komunën Gostimë.

Fillimi i efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”* (i ndryshuar), e ka gjetur në këtë pozicion pune prandaj, me të drejtë (*pavarësisht tejkalimit të afatit 60 ditore që parashikonte ligji për këtë rast*), në kushtet kur kjo punonjëse nuk kishte më shumë se 1 vit në këtë pozicion pune, në bazë të nenit 67, pika 4, të ligjit në fjalë, njësia përgjegjëse e komunës, me aktin nr. 561., prot datë 03.11.2014, e ka deklaruar atë si *“nëpunës civile në periudhë prove”*, në kategorinë ekzekutive, të pozicioneve të shërbimit civil.

Më pas, ashtu si e kemi përmendur edhe më sipër, me Urdhrin nr. 5, datë 25.02.2015, punonjësja \*\*\*\*\* është emëruar në pozicionin e “Përgjegjëses së Zyrës së Financës”, në Komunën Gostimë.

Duke analizuar procedurat e zhvilluara për plotësimin e këtij pozicioni pune, konstatohet se ky emërim është bërë në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi me fillimin e efekteve juridike të tij, çdo emërim duhej bërë duke respektuar procedurën dhe rregullat e përcaktuara në nenet 22 dhe 23 të ligjit, përndryshe ai konsiderohet si i pavlefshëm.

Për më tepër, punonjësja në këtë rast, ishte ende nëpunëse civile në periudhë prove, e cila nuk e kishte marrë konfirmimin si nëpunëse civile, e për këtë arsye, ajo kishte pengesë ligjore edhe për të aplikuar për të marrë pjesë në një procedurë për ngritje në detyrë.

Në këto rrethana të pasqyruara më sipër, mosrespektimi i formës dhe procedurës së kërkuar nga ligji aktual për nëpunësin civil, në lidhje me emërimin në shërbimin civil, në bazë të neneve 115/a, 116/c dhe 117/1, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative”, e bën aktin, e për rrjedhojë edhe marrëdhënien e punës në shërbimin civil, në pozicionin “Përgjegjëse e Zyrës së Financës”, të pavlefshme.

Po kështu, kalimi i kësaj punonjëseje, në një detyrë më të lartë në kundërshtim me ligjin, nuk mund të konsiderohet si ndërprerje për një shkak të ligjshëm e periudhës së provës në pozicionin e mëparshëm, “inspektore e tatim-taksave”, pasi në pikën 3, të Kreut I, të Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, nuk lejohet transferimi i përkohshëm i nëpunësit civil në periudhë prove.

Por, nga ana tjetër, fakti që punonjësja nuk ka realizuar brenda periudhës së provës, trajnimin e detyrueshëm në ASPA dhe më tej, nuk janë përmbushur kërkesat e tjera të nenit 24, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nuk mund të penalizojë punonjësen në fjalë, pasi kjo situatë paligjshmërie nuk është krijuar për faj të kësaj punonjëse, por për shkak të mos zbatimit të ligjit dhe akteve nënligjore, nga ana e njësisë përgjegjëse të ish komunës Gostimë. Në kushtet aktuale, kjo punonjëse, gëzon statusin e punësimit në shërbimin civil, në pozicionin e punës se inspektorit dhe në këtë pozicion mund të realizojë edhe të gjitha të drejtat që rrjedhin prej këtij statusi.

Për sa analizuam më lart, rezulton i paligjshëm edhe Vendimi nr. 3, datë 21.09.2015, i njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Çërrik, i cili në pikën 1/18 të tij, ka njohur dhe konfirmuar punonjësen \*\*\*\*\*, si “nëpunëse civile në periudhë prove”, në momentin e ristrukturimit, në pozicionin aktual, që është sipas strukturës “Përgjegjëses i Zyrës së Financës”, në njësinë administrative Gostimë.

Në këtë rast, ky organizëm, në zbatim të procedurave ligjore, fillimisht duhet të verifikonte, procedurën e kryer për nxjerrjen e Urdhrit nr. 5, datë, 25.02.2015, të Kryetarit të Komunës Gostimë, për emërimin në detyrë të punonjësës \*\*\*\*\* në pozicionin e punës, “Përgjegjëse

e Zyrës së Financës”, të cilat parashikohen në nenet 22 dhe 23, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Në rastin e një emërimi të kryer duke mos respektuar procedurën dhe rregullat e përcaktuara në dispozitat e mësipërme dhe në aktet nënligjore që i specifikojnë ato, kjo njësi duhet të niste procesin e rregullimit të ligjshmërisë, duke marrë masat për shfuqizimin e aktit që e ka emëruar punonjësen në fjalë në pozicionin e punës “Përgjegjëse e Zyrës së Financës”.

Deklarimi i statusit të punësimit, për punonjësen \*\*\*\*\* , në periudhë prove, në pozicionin e mëparshëm, “Inspektore e Tatim-Taksave”, është një e drejtë e fituar prej saj për shkak të ligjit dhe për këtë arsye, me këtë status, njësia përgjegjëse duhet të vijonte procedurën me aktet e tjera administrative, në zbatim të procesit të ristrukturimit të këtij institucioni.

Nisur nga sa më sipër, arrihet në përfundimin se, aktet administrative, nr. 615/4 prot., datë 21.10.2015, i Kryetarit të Bashkisë Çërrik, për njoftimin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës të nëpunëses \*\*\*\*\* , i cili ka shoqëruar vendimin nr. 6/5, datë 21.10.2015, të njësisë përgjegjëse, për lirim nga detyra të punonjëses në fjalë, pavarësisht formës, në përmbajtje kanë dalë duke mos pasqyruar saktë, rrethanat e momentit të deklaramit të statusit të punësimit, sipas nenit 67, të ligjit aktual për nëpunësin civil.

Në përfundim, duke vlerësuar ato ç`ka u analizuan në këtë vendim, çmoj se, për të vendosur ligjshmërinë e rastit të shqyrtuar, njësia përgjegjëse duhet të rregullojë përmbajtjen e akteve administrative që përmendëm më sipër, duke theksuar faktin se, deklarimi i statusit të punësimit për këtë punonjëse, duhet të bëhet si nëpunëse civile në periudhë prove, në pozicionin e punës “Inspektore e tatim taksave” , e për këtë arsye, edhe akti i ndërprerjes së marrëdhënies së punës që ka dalë për shkak të ristrukturimit, duhet të pasqyrojë të drejtat që i lindin asaj, në kategorinë ekzekutive të shërbimit civil.

Në këto rrethana, njësia përgjegjëse duhet të marrë masat për të revokuar aktin administrativ nr. 5, datë, 25.02.2015, për emërimin e punonjëses \*\*\*\*\* në detyrën, “Përgjegjëse e Zyrës së Financës”, si akt absolutisht i pavlefshëm, pasi ndodhemi në kushtet e nenit 115, pika “a”, 116 pika “c” dhe 117, pika 1, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative në R.SH”.

Po kështu, njësia përgjegjëse, duhet të pasqyrojë në të gjithë praktikën e ristrukturimit, që përbëhet nga dokumentacioni i nxjerrë nga Komisioni i Ristrukturimit, vendimmarrja e njësisë përgjegjëse dhe nga akti i njoftimit, i nxjerrë nga Kryetari i Bashkisë Çërrik, me nr. 615/4 prot., datë 21.10.2015, “Për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, në njësinë administrative Gostimë për shkak ristrukturimi”, faktin që kjo nëpunëse duhet të gëzojë të drejtat që rrjedhin nga pozicioni i punës “Inspektore e tatim taksave”.

#### **Për këto arsye:**

Bazuar në nenet 14, 15 dhe 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; nenet 115, pika “a”, 116 pika “c” dhe 117, pika 1, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative në R.SH”; nenin 35 të Rregullores “Mbi procedurat e

*mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil” ,

#### **VENDOSA:**

1. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse, që të drejtojë procesin e rregullimit të ligjshmërisë, për revokimin e Urdhrit të Kryetarit të Komunës Gostimë nr. 5, datë, 25.02.2015, për emërimin në detyrë të punonjës \*\*\*\*\* “Përgjegjëse e Zyrës së Financës”.
2. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse, që të drejtojë procesin e rregullimit të ligjshmërisë, për plotësimin e vendimit nr. 3, datë, 21.09.2015, në pikën 1/18, që është marrë nga kjo strukturë, në momentin e ristrukturimit, në pjesën e konfirmimit të statusit të punësimit të punonjës \*\*\*\*\* , duke e përcaktuar në këtë akt, si: “*nëpunës civil në periudhë prove*”, në pozicionin e mëparshëm të punës, “*Inspektore e Tatim-Taksave*”.
3. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse, që të drejtojë procesin e rregullimit të ligjshmërisë, për plotësimin e vendimit nr. 6/5, datë 21.10.2015, të njësisë përgjegjëse, për lirimin nga detyra të punonjës \*\*\*\*\* , shoqëruar nga akti administrativ i Kryetarit të Bashkisë Cërrik, nr. 615/4 prot., datë 21.10.2015, “*Dërgim vendimi*”, duke pasqyruar në këtë akt, në mënyrë të shprehur, statusin e saj të punësimit, në momentin e ristrukturimit të institucionit, si: “*nëpunës civil në periudhë prove*”, në pozicionin e punës, “*Inspektor i Tatim-Taksave*”.
4. Në aktin e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, të përcaktohen të gjitha përfitimet prej pikave 7 dhe 8, të nenit të mësipërm, që kanë të bëjnë me dhënien e një shpërblimi në përputhje me vjetërsinë në shërbimin civil dhe mundësinë që brenda një periudhe 2 vjeçare, të konkurrojnë si nëpunëse civile për procedurat e lëvizjes paralele, apo ngritjes në detyrë, ose të emërohet në mënyrë të përkohshme, me pëlqimin e saj, në pozicione të shërbimit civil, që lirohen përkohësisht, për shkak sëmundje, leje lindje e arsye të tjera ligjore, në nivelin ekzekutiv.
5. Bashkia Cërrik, të zbatojë vendimin brenda **15** ditëve nga data e marrjes dijeni dhe pas përfundimit të këtij afati, të njoftojë me shkrim Komisionerin, për zbatimin e vendimit.
6. Të njoftohen për këtë vendim, Bashkia Cërrik dhe kërkuesja \*\*\*\*\*.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**